

Gjeopolitika e Shqipërisë - mundësia e kyçjes së Republikës së Kosovës në gazsjellësin - TAP

*Mersel Bilalli**

Abstrakt

Në Ballkan, Evropë dhe botë zhvillohen beteja të ashpra për atë se kush do t'i kontrollojë tubacionet gazpërçuese, gjë e cila nuk nënkupton vetëm favore financiare, por edhe pozicione të fuqishme gjeopolitike.

Pas dështimit të dy projekteve të mëdha gazpërçuese për Ballkanin - projekti "Rrjedha Jugore" (South Stream) dhe "NABUCCO", definitivisht fitoi projekti TAP (Trans-Adriatic Pipelines), projekti më i madh në Ballkan, në 100 vitet e fundit, i cili Shqipërinë do ta shndërrojë në arterie të rëndësishme energjetike të Evropës. Kjo dukshëm do të ndikojë në dinamizimin e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, i cili nga ky gazsjellës do të përfitojë mbi 15 mijë punësime të reja në pesë vitet e ardhshme dhe mbi një miliard euro do të fitojë nga taksa e tranzitimit në 20 vitet në vijim.

Tani për tani projekti TAP parasheh dy krahë të vetat: Krahu, i cili lidhet në tubin kryesor të gazsjellësit TAP në Greqi, vazhdon për në Bullgari (180 kilometra i gjatë) dhe i cili parashihet të vazhdojë përmes Rumanisë dhe Hungarisë në drejtim të Evropës Qendrore. Krahu tjetër, i ashtuquajturit-IAP (Ionian-Adriatic Pipelines), pra Gazsjellësi Adriatik-Jon, do të furnizonte Malin e Zi, Bosnjën e Hercegovinën dhe Kroacinë, kurse një shtesë e këtij krahu do të kalonte përmes Maqedonisë dhe Kosovës.

* Dr. Mersel Bilalli, profesor i asociuar në Kolegjin AAB në Prishtinë, E-mail: mersel.b@gmail.com

Pa dilemë se ky projekt do të jetë tejet i rëndësishëm jo vetëm për zhvillimin e rajonit, por edhe për stabilizimin dhe integrimin e tij.

Fjalë kyç: *gazpërçuesi TAP, pozita gjeopolitike, zhvillimi dhe stabilizimi i rajonit, kycja e Kosovës*

Hyrje

Një vështrim shkencor kushtuar Gazsjellësit Trans-Adriatik – TAP (Trans – Adriatik Pipelines), domosdo duhet trajtuar në kuadër të korpusit të të drejtave themelore të shteteve si subjekt primar i të drejtës ndërkombëtare. Kjo materie bie në lëminë e të drejtës së shteteve në tranzitim.¹ Tanimë këto norma juridike universale janë të përfshira në shumë akte ndërkombëtare duke përfshirë edhe Kartën e OKB-së.

E drejta ndërkombëtare, të drejtën në tranzitim e konsideron si të drejtë themelore të çdo shteti dhe ajo përfshin të drejtën në komunikacion të lirë e të papenguar me të gjitha mjetet e komunikacionit dhe lidhjeve në territorin e shteteve të tjera. Pra, shtetet kanë të drejtë në tranzitim me të gjitha mjetet transportuese rrugore, hekurudhore, ajrore, ujore, përmes tubacioneve, paisjeve radiodifuzive, telekomunikative, etj. Kjo e drejtë ndeshet me transformime intensive duke pasur parasysh dinamikën e zhvillimit teknologjik, ekonomik, tregun e hapur botëror, komunikimin kulturor, lëvizjet e njerëzve dhe këmbimin e vlerave në botë. Një zhvillim i tillë domosdo

¹ Gjer në shekullin XVII, është konsideruar si e drejtë ekskluzive e shtetit, se cilit shtet do t'i mundësojë tranzitim nëpër territorin e vet. Por, me zhvillimin e ekonomisë dhe tregtisë ndërkombëtare lind instituti – e drejta në tranzitim. Shif. S. Avramov; M. Kreça, Megjunarodno javno pravi, Beograd, 2003, f.100

determinon ndërvarshmëri më të madhe në mes shteteve, rajoneve dhe mbarë botës.

Karta e OKB-së në nenin 1 (al.3), përcakton - "bashkëpunimin në mes shteteve në zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare, ekonomike, sociale...". Format dhe mënyrat e realizimit të bashkëpunimit dhe komunikimit në mes shteteve rregullohen me norma të përgjithshme ndërkombëtare dhe me marrëveshje bilaterale në mes shteteve. OKB-ja, kësaj problematike i jep peshë të veçantë, madje ekziston një Komitet special për hulumtimin e parimeve të së drejtës ndërkombëtare mbi marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimin në mes shteteve. Njëherit duhet potencuar se e drejta e shteteve në komunikacion rrjedh nga e drejta themelore e shteteve për ekzistencë.

Nga e drejta në komunikacion rrjedhin edhe të drejtat e tranzitimit nëpër territorin e shtetit tjetër apo shteteve të tjera me të gjitha mjetet e komunikacionit.² Këto të drejta mund të kufizohen apo reduktohen vetëm nëse është në pyetje rrezikimi i sigurisë nacionale të shtetit përmes territorit të të cilit realizohet tranzitimi. Por, nëse pengimi i tranzitimit nuk mbështetet në arsye serioze rrezikimi sigurie, shteti tranzitues ka të drejtë që problemin ta shtrojë para OKB-së dhe organizatave të tjera kompetente, duke përfshirë edhe Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë.

TAP - projekt shekullor që përfitoi nga acarimi Rusi - Perëndim

Dekadave të fundit, vazhdimisht janë zhvilluar beteja të ashpra në mes magnatëve energjetikë dhe politikë botërorë, për atë se kush do të jetë padron i tubacioneve gazpërçuese në Ballkan,

² Për tranzitin detar, shih, M. Bilalli, *Slobodata na moreto i pristap na Republika Makedonija do moreto*, (punim i doktoratës), Shkup, 2007

duke përfshirë edhe ballkanin perëndimor. Ky pozicion nuk nënkupton vetëm favore financiare nga shfrytëzimi i resurseve energjetike dhe nga tranzitimi i tyre, por edhe shumë më tepër.

Fillimisht, në konkurrencë ideore për rajonin e Ballkanit u futën dy projekte të mëdha gazpërçues - projekti "Rrjedha Jugore" (South Stream) dhe "NABUCCO". I pari ishte projekt me pjesëmarrje dominante të kapitalit rus përmes "Gasprom"-it, kurse i dyti projekt evropian. Natyrisht se në kushte të një klime të relaksuar politike dhe ekonomike në mes vendeve perëndimore dhe Ruisë, elementi financiar ishte dominant për atë se cili nga këta dy projekte do të fillojë të realizohet apo eventualisht që të dy projektet paralelisht. "Rrjedha Jugore" do të transportonte gazin natyror përmes Turqisë, Bullgarisë, Serbisë, Hungarisë dhe do të përfundonte në Austri, ku do të kyçej në rrjetin e dendur të Evropës qendrore dhe perëndimore. Edhe "NABUCCO" do të kalonte nëpër këto shtete, me atë që do ta anashkalonte Serbinë, me siguri për qëllime shmangieje një Serbie akoma jo të stabilizuar në rajon. Por, ky i fundit pati dështuar në momentin kur gjiganti energjetik "BP" (British Petroleum) ishte tërhequr nga idea.

Për dallim nga "Nabuko", projekti "Rrjedha Jugore" në ambient të relaksuar politik në mes Ruisë dhe shteteve Perëndimore u imponua si projekt serioz realizues. Madje në Bullgari filluan punimet e para për realizimin e tij. Por, me rastin e acarimit të dukshëm të marrëdhënieve Rusi - Perëndim lidhur me Ukrainën, e në veçanti me aneksimin e Krimesë nga Federata Ruse, si dhe me fillimin e luftës në lindje të këtij shteti, pasoi acarimi i dukshëm në marrëdhëniet e përgjithshme Rusi - Perëndim.³ Natyrisht se sanksionet ndaj Ruisë drejtpërdrejt

³ Lidhur me konfliktin Ukrainë - Rusi, shif, Paul Stevens, *Transit troubles, Pipelines as a resorce of conflict*, A Chatham House Report, March 2009

goditën projektin “Rrjedha Jugore”.⁴ Komisioni Evropian eliminoi këtë projekt, por me argumente se projekti në fjalë nuk kishte paraparë të ndërtohet dhe të operojë sipas dispozitave të UE-së. Qeveria bullgare kishte deklaruar se nga dështimi i këtij projekti, Bullgaria do të pësojë humbje afro 400 miliardë dollarësh.⁵ Por, njëherit përfaqësuesi qeveritar bullgar Krasen Stančev⁶ kishte potencuar se sikur të vazhdohet me projektin “Rrjedha Jugore” – Bullgaria do të jetë e detyruar që t’i paguajë dëmshpërblim Unionit Evropian në sasi prej rreth 8000 euro për çdo tatimpagues bullgar.

Fakt se “Rrjedha Jugore” dukshëm do ta forconte pozicionin e Rusisë në Ballkan dhe Evropë, po të kemi parasysh se rreth 10 përqind e nevojave evropiane për gaz do të kalonin përmes projektit në fjalë. Kjo domosdo do të ndikonte edhe në politikbërjen e më shumë shteteve ballkanike përmes të cilave do të kalonte gazsjellësi, si dhe shteteve të cilat do të furnizoheshin me gaz nga ky rrjet.⁷

Idea mbi projektin TAP doli që në vitin 2003 nga kompania zvicerane “EGL GROUP” (tani “Axpo”), e cila tre vite më vonë realizoi një studim fizibiliteti. Lidhur me trasenë e saj u patën shtruar dy alternativa. E para, nga Turqia, përmes Bullgarisë, Maqedonisë dhe Shqipërisë, ku projekti do të përfundonte në Italinë jugore. E dyta, nga Turqia përmes Greqisë dhe Shqipërisë

⁴ <http://www.dw.com/sr/ju%C5%BEEni-tok-i-njegova-logika/a-17681220> (04. 06.2014)

⁵ Njëherit u pat theksuar se Bullgaria do të kërkojë dëmshpërblim nga Unioni Evropian. Shif, <http://www.vreme.com/cms/view.php?id=1250106> (02. 12. 2014) .Poashtu, <http://www.reuters.com/article/us-russia-europe-pipeline-eu-idUSKCN0JI18720141204?feedType=RSS&feedName=topNews/> (04. 12. 2014)

⁶ Stančev është kryesues i Bordit të Institutit Bullgar për Tregti të Hapur.

⁷ Cross-Border Oil and Gas Pipelines: Problems and Prospects. UNDP/World Bank Energy Sector Management Assistance Programme (ESMAP), Qershor, 2003

jugore dhe traseja do të përfundonte në Itali (Brindizi).⁸ Më 13 Shkurt 2008, "EGL Group" dhe kompania norvegjeze "Statoil" nënshkruan marrëveshje për angazhim të përbashkët në dhënie përkrahje ndërtimit të projektit TAP dhe operimit me të.⁹ Projekti për transportimin e gazit për në TAP, do të bëjë transportimin e gazit natyror nga Azerbajxhani, pra nga fushat e gazit "Shah Deniz II", përmes mega-gazpërçuesit ekzistues turk TANAP (Trans-Anatolian Natural Gas Pipeline) dhe do të lidhet me gazsjellësin TAP në kufirin greko-turk. (shih hartën)



Komisioni Evropian kishte vlerësuar se projekti TAP dukshëm do të ndikojë, jo vetëm në diversitetin e furnizimit me energji të Evropës pa e dëmtuar konkurrencën në tregun e përbashkët, por edhe në forcimin e paqes dhe sigurisë rajonale.¹⁰ Komisioni vlerësoi se duke e falenderuar projektin gazsjellës

⁸http://web.archive.org/web/20120308073539/http://www.egl.eu/eglch/en/home/media/news/archive/2007/2007_03_13.html (13.03.2007)

⁹Shih, <http://www.upstreamonline.com/live/article1152480.ece>

¹⁰Lidhur me interesat e kompanive të gazit në treg, shif G. Mackerron & P.J.G. Pearson (eds), *The UK Energy Experience: a Model or a Warning?*, Imperial College Press, London, 1996: pp. 109-122.

TAP, konkurenca në tregun evropian¹¹ do të forcohet pasi që do të kemi më shumë furnizim dhe më tepër oferta me kyçjen e trasesë së re.¹² „Miratimi i sotshëm i marrëveshjes për TAP paraqet hap të rëndësishëm në drejtim të përfundimit të korridorit jugor të gazit“ - kishte deklaruar nënkryetari i Komisionit Evropian i ngarkuar për Unionin Energjetik Maroş Šefčovič.¹³ “Me rastin e aprovimit të marrëveshjes në mes Gazsjellësit Trans-Adriatik - TAP dhe Greqisë, hapet rruga për fillimin e punëve në ndërtimin e këtij gazsjellësi të ri në Evropë“ - thuhet në faqen e internetit të Komisionit Evropian më 04 mars 2016.¹⁴ Komisioni Evropian po ashtu ka potencuar se domethënia e këtij projekti është aq e madhe dhe tejkalon atë që nënkupton dhënie ndihmë shtetërore e rregulluar me dispozita të UE-së, e që më pas të konstatojë se kjo nuk ndeshet me dispozitat e UE-së.¹⁵ Me këtë faktikisht u dha drita jeshile që projekti gazsjellës TAP të hyjë në Evropë.

Qeveria e Shqipërisë¹⁶ i dha përkrahje të pazezervë projektit TAP duke e konsideruar si projektin më të madh në Ballkan në 100 vitet e fundit.¹⁷ Gazsjellësi Trans-Adriatik (TAP) do të kalojë përmes veriut të Greqisë, jugut të Shqipërisë dhe përmes tubave nën det në Adriatikon jugor, do të kyçet në rrjetin evropian të gazsjellësve në jugun e Italisë (në Brindizi). Projekti tani më është

¹¹ James T. Jensen. *The Development of a Global LNG Market: Is It Likely? If So, When?* NG5, Oxford Institute of Energy Studies, Oxford, 2004, p. 2-3

¹²http://www.b92.net/biz/vesti/svet.php?yyyy=2016&mm=03&dd=04&nav_id=1103731 (04.03.2016)

¹³<http://www.euractiv.rs/energetika/9728-ek-odobrila-gasovodu-tap-ulaz-u-evropu-> (4.03.2016)

¹⁴<http://www.tanjug.rs/full-view.aspx?izb=233121> (04.03.2016)

¹⁵<http://novaekonomija.rs/sr/vesti-iz-sveta/evropska-komisija-odobrila-novi-gasovod-tap-za-evropu> (04.03.2016)

¹⁶<http://www.dw.com/sr/gasovod-tap-napreduje-bez-moskve/a-17974547> (5.10.2014)

¹⁷<http://www.energyobserver.com/vesti.php?lang=1&ID=38711> (16.05.2016)

tejet serioz për realizim. Madje, qysh në vitin 2010 TAP zyrtarisht kishte hapur zyrat në Greqi, Shqipëri dhe Itali.¹⁸

Me rastin e arritjes së tubave të para në portin e Durrësit për gazsjellësin TAP, kryeministri i Shqipërisë Edi Rama theksoi se përmes gazsjellësit TAP, Shqipëria do të shndërrohet në arterie të rëndësishme energjetike të Evropës. Më tej ai theksoi se ky projekt dukshëm do të ndikojë në dinamizimin e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, që nga ky gazsjellës do të përfitojë mbi 15 mijë punësime të reja në pesë vitet e ardhshme dhe mbi një miliard euro do të fitojë nga taksa e tranzitimit në 20 vitet në vijim.¹⁹

Nga 878 kilometra gjatësi e përgjithshme e gazsjellësit TAP - 550 kilometra do të kalojnë nëpër Greqi, 215 kilometra nëpër Shqipëri, 105 kilometra nën Detin Adriatik, dhe 8 kilometra në brendi të Italisë.²⁰ Kapaciteti i TAP do të jetë rreth 10 miliardë metra kub gaz natyror për vit. Punimet kanë filluar edhe pse shumë organizata qytetare ambientaliste greke kundërshtojnë pjesë të ndryshme të traseve nëpër Greqi.²¹

Qeveria greke dhe Kompania TAP kanë nënshkruar marrëveshje sipas së cilës përcaktohet regjim i veçantë tatimor për TAP në Greqi për 25 vitet në vijim, duke filluar nga startimi me punimet. Por, kjo çështje akoma është në shqyrtim brenda institucioneve të Unionit Evropian se vallë a është kjo në

¹⁸http://www.seenews.com/news/latestnews/trans-adriaticpipelineopensofficesinalbania_italy_greece-115448/

¹⁹[http://plusinfo.mk/vest/66875/pocna-izgradbata-na-tap-rama-najavi-15000-vrabotuvanja-za-pet-godini\(18.04.2016\)](http://plusinfo.mk/vest/66875/pocna-izgradbata-na-tap-rama-najavi-15000-vrabotuvanja-za-pet-godini(18.04.2016))

²⁰Që në vitin 2013, Greqia, Shqipëria dhe Italia nënshkruan marrëveshje për ndërtimin e proektit TAP, të gatshme që në start të investojnë një miliard euro.

²¹Lidhur me aspektet e sigurisë transportuese shih, Keneth P. Green & Taylor Jackson, *Safety in the Transportation of Oil and Gas: Pipelines or Rail?*, (Fraser Research Bulletin, Fraser Institute. Avgust, 2015)

përputhje me dispozitat e UE (udhëzimet), që kanë të bëjnë me ndihmën shtetërore në sferën e energjetikës dhe mbrojtjes së ambientit jetësor.

Sa i përket fuqisë financiare, pas gazsjellësit TAP qëndrojnë kompani të fuqishme financiare me renome botërore. Duhet theksuar se për momentin si aksionarë të projektit gazsjellës "TAP" janë kompanitë: - "BP"- (20%); "Socar"- (20%); "Snam"- (20%); "Fluxys" - (19%); "Enagas"- (16%); dhe "Axpo" (5%).²²

Krahët e gazsjellësit TAP

Tani për tani projekti TAP parasheh dy krahë të vetat. Krahu i cili lidhet në tubin kryesor të gazsjellësit TAP në Greqi, vazhdon për në Bullgari (180 kilometra i gjatë), dhe i cili parashihet të vazhdojë përmes Rumanisë dhe Hungarisë në drejtim të Evropës qendrore. Kurse krahu i dytë, i ashtuquajtur i -IAP (Ionian-Adriatic Pipelines), pra Gazsjellësi Adriatik-Jon, parashihet të ndërtohet në gjatësi prej 516 kilometra, e që do të furnizonte Malin e Zi, Bosnjën e Hercegovinën dhe Kroacinë, kurse një shtesë e këtij krahu do të kalonte përmes Maqedonisë dhe Kosovës.

Në veçanti Mali i Zi është tejet i interesuar për projektin IAP, jo vetëm për qëllim të furnizimit nga ky gazsjellës me çmim më të ulët se shumë burime të tjera, por njëherit ky shtet në vazhdimësi angazhohet për realizimin e projektit TAP dhe në koordinim me disa shtete fqinje, në veçanti me Kroacinë dhe Bosnjën e Hercegovinën, Mali i Zi synon ta fuqizojë pozicionin e vet tranzitues për në vendet fqinje, që nënkupton favore të mëdha

²²Në fillim ishin të kyçura kompania gjermane "E.ON" dhe ajo franceze "Total", por ato u paten tërhequr.

financiare dhe politike.²³ Parashihet që përmes sistemit IAP (Ionian Adriatic Pipelines), Mali i Zi të investojë rreth 100 milionë euro (mjete financiare që pritet të sigurohen nga fonde evropiane), e të cilët shpejt do të mund të ktheheshin kur kemi parasysh fitimin nga taksa e tranzitimit nëpër territorin e këtij shteti, që do të ishte mbi 20 milionë euro në vit.²⁴ Lidhja me gazsjellësin nga Shqipëria do të bëhej në Bozhaja, pra afër kufirit shqiptaro-malazez, duke vazhduar për në Podgoricë. Pastaj traseja do të vazhdonte përmes Lovçenit deri në Lushticë, ku edhe do të lidhej me Kroacinë.

Natyrisht se peshë shumë të madhe ka lidhja edhe me Maqedoninë dhe Kosovën, trase e cila do të hynte në afërsi të Strugës dhe përmes Maqedonisë perëndimore do të dilte në Kosovë, e pastaj do të vazhdonte për në Serbi (e njohur si WBR – Western Balkan Ring). Një lidhje e tillë pa dilemë se dukshëm do ta relaksonte ambientin politik në rajon, e në veçanti në mes Kosovës dhe Serbisë. Njëherit e gjithë kjo, Shqipërinë do ta shndërronte në epiqendër energjetike ballkanike, prej ku edhe dukshëm do të forcohej relevanca e saj gjeopolitike në dimensione rajonale, por edhe Evropiane.

Përfundimi

Gazsjellësi TAP për momentin paraqet projektin më të madh për transportim të gazit në Ballkanin Perëndimor. Pa dilemë se ky

²³Shefi i diplomacisë së Malit të Zi (njëherit zëvendës-kryeministër i qeverisë), në 20 mars 2013 për këtë qëllim realizoi një vizitë në Tiranë duke takuar kolegun e tij Edmond Panariti. <http://serbia-energy.eu/sr/crna-gora-crna-gora-zainteresovana-za-transjadranski-gasovod-tap/> (21.03. 2013)

²⁴Kur ta kemi parasysh se nga IAP-i me kapacitet rreth 2,5 miliardë metra kub gaz në vit dhe çmimi i tanihëm i tranzitimit që është 1 cent euro për meter kub, del fitimi mbi 20 milion evro.

projekt dukshëm do të ndikojë në stabilizimin, zhvillimin dhe integrimin e shteteve të rajonit dhe Ballkanit Perëndimor si tërësi. Këto shtete, pos favoreve zhvillimore-ekonomike, në masë të konsiderueshme do të përfitojnë edhe nga relevanca politike dhe gjeopolitike.

Projekti në veçanti dukshëm faktorizon Shqipërinë, si në dimensionin rajonal ashtu edhe atë evropian. Prej këtui, këtij projekti duhet t'i jepet publicitet shumë më i madh mediatik me qëllim të mobilizimit të bashkësisë biznesore, institucioneve shtetërore e lokale, si dhe komponentëve të tjerë, me qëllim realizimin sa më me sukses të këtij kapaciteti të madh energjetik.

Shtetet e rajonit duhet të bëjnë ndryshime adekuate ligjore me qëllim të eliminimit të pengesave të mundshme administrative, në rend të parë ato që kanë të bëjnë me eksproprijimin e tokave, të cilat dukshëm mund ta zvarritin realizimin e këtij projekti.

Institucionet e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me ato të Shqipërisë dhe të Maqedonisë, duhet në vazhdimësi të organizojnë takime ndërinstitutionale dhe profesionale mes tyre, me qëllim të koordinimit sa më efikas të punëve dhe aktiviteteve të shumta lidhur me realizimin e këtij projekti.

Bibliografia

Avramov S; Kreça M, *Megjunarodno javno pravi*, Beograd, 2003, f.100

Bamberger C. and Waelde T.W, "*The Energy Charter Treaty: Entering a New Phase*," Working Paper, CEPMLP, University of Dundee, 1998)

Bilalli M. *E drejta ndërkombëtare publike*, FON University, Shkup, 2008

Cross-Border Oil and Gas Pipelines: Problems and Prospects. UNDP/World Bank Energy Sector Management Assistance Programme (ESMAP), June, 2003.

Keneth P. Green & Taylor Jackson, *Safety in the Transportation of Oil and Gas: Pipelines or Rail?*, (Fraser Research Bulletin, Fraser Institute. Avgust, 2015

Korchemkin Mikhail, *East European Gas analysis*, Malvern, 2016, PA 19355 USA

James T. Jensen. *The Development of a Global LNG Market: Is It Likely? If So, When?* NG5, Oxford Institute of Energy Studies, Oxford, 2004

Mackerron G. and Pearson P.J.G. (eds), *The UK Energy Experience: a Model or a Warning?*, Imperial College Press, London, 1996: pp. 109-122.

Stevens Paul, "Pipelines or Pipe Dreams? Lessons from the History of Arab Transit Pipelines," Middle East Journal, Spring 2000

Stern, J. P. 'The Russian Ukrainian Gas Crisis of January 2006', comment from the Oxford Institute of Energy Studies, 2006, http://www.oxfordenergy.org/pdfs/comment_0106.pdf

Stevens Paul, *Transit troubles, Pipelines as a resorce of conflict*, A Chatham House Report. March 2009.

Linket

<http://www.upstreamonline.com/live/article1152480.ece>

<http://www.reuters.com/article/us-russia-europe-pipeline-eu-idUSKCN0JI18720141204?feedType=RSS&feedName=topNews/>

<http://www.balkans.com/open-news.php?uniquenumber=11360513>

<http://www.vreme.com/cms/view.php?id=1250106>

<http://www.energyobserver.com/vesti.php?lang=1&ID=38711>

<http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/13/Ekonomija/1771430/EU%3A+%E2%80%9CJu%C5%BE%20ni+koridor%E2%80%9C>

9D+umesto+%E2%80%9CJu%C5%BEnog+toka%E2%80%9D.html

<http://www.dw.com/sr/ju%C5%BEni-tok-i-njegova-logika/a-17681220>

<http://novaekonomija.rs/sr/vesti-iz-sveta/evropska-komisija-odobrila-novi-gasovod-tap-za-evropu>

http://www.b92.net/biz/vesti/svet.php?yyyy=2016&mm=03&dd=04&nav_id=1103731

<http://www.tanjug.rs/full-view.aspx?izb=233121>

<http://www.dw.com/sr/gasovod-tap-napreduje-bez-moskve/a-17974547>

<http://serbia-energy.eu/sr/crna-gora-crna-gora-zainteresovana-za-transjadranski-gasovod-tap/>

<http://mondo.rs/a881383/Info/Ekonomija/TAP-novi-gasovod-u-Evropi-od-Azerbejdzana-preko-Grcke-i-Albanije-do-Italije.html>